



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

Tiranë, më 1.2.2022

Dokument parlamentar

Komision përgjegjës

R A P O R T

PËR PROJEKTLIGJIN “PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.7918, DATË 13.4.1995, “PËR MIRATIMIN ME NDRYSHIME TË DEKRETIT NR.1030, DATË 23.2.1995 “PËR EMETIMIN DHE SHPËRNDARJEN E BONOVE TË PRIVATIZIMIT (LEKËVE TË PRIVATIZIMIT)”, DHE DEKRETIT NR.1049, DATË 27.3.1995 “PËR DISA PLOTËSIME NË DEKRETIN NR.1030, DATË 23.2.1995””, TË NDRYSHUAR”

I. Hyrje.

Komisioni për Ekonominë dhe Financat, në cilësinë e Komisionit përgjegjës, në mbledhjen e datës 1 shkurt 2021, shqyrtoi projektligjin “Për një ndryshim në ligjin nr.7918, datë 13.4.1995 “Për miratimin me ndryshime të dekretit nr.1030, datë 23.2.1995 “Për emetimin dhe shpërndarjen e bonove të privatizimit (lekëve të privatizimit)”, dhe dekretit nr.1049, datë 27.3.1995 “Për disa plotësime në dekretin nr.1030, datë 23.2.1995””, të ndryshuar”. Projektligji është propozuar nga Këshilli i Ministrave. Komisioni për Ekonominë dhe Financat e shqyrton këtë projektligj sipas rregullave të parashikuara në nenet 32-38 të Rregullores së Kuvendit.

Komisioni caktoi relatores, për këtë projektligj, znj. Antoneta Dhima.

Në mbledhjen e Komisionit ishin të ftuar, nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë:

- Z. Besart Kadia, Zëvendësministër;
- Z. Endrit Duçka, Drejtor i Drejtorisë së Drejtimit të Pronës Publike;

- Z. Nuri Sopaj, Përgjegjës i Sektorit të Shitjeve në Drejtorinë e Drejtimit të Pronës Publike.

II. Baza ligjore.

Këshilli i Ministrave e ka propozuar projektligjin bazuar në nenet 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës. Projektligji shoqërohet me relacionin përkatës, sipas kërkesave të nenit 68 të Rregullores së Kuvendit. Miratimi i këtij projektligji kërkon një shumicë të thjeshtë votash, sipas nenit 55, pika 3 të Rregullores së Kuvendit.

III. Qëllimi dhe përmbajtja e projektligjit.

Projektligji synon shtyrjen nga 31.12.2021, në 31.12.2023, të afatit të vlefshmërisë së bonove dhe lekëve të privatizimit. Qëllimi i kësaj mase është krijimi i mundësive personave, që zotërojnë bono e lekë privatizimi, që t'i përdorin ato edhe gjatë viteve 2022 dhe 2023.

Mundësitë për përdorimin e bonove dhe lekëve të privatizimit janë në këto drejtime:

- Një numër i konsiderueshëm i objekteve që administrohen nga Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Brendshme, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, organet e pushtetit vendor etj nuk janë privatizuar ende. Shumë prej këtyre objekteve shtrihen në pronat e ish-pronarëve, të cilëve u është njohur apo kthyer prona me vendim të komisionit të kthimit të pronave. Duke qenë se pronarët e trojeve kanë të drejtën e parablerjes së objekteve që ngrihen mbi to, kjo masë do t'i ndihmojë ata për të likuiduar një pjesë të vlerës së këtyre objekteve me bono apo lekë privatizimi.
- Punonjësit e shoqërive aksionare mund t'i përdorin bonot dhe lekët e privatizimit për blerjen e aksioneve të këtyre shoqërive.
- Një numër i konsiderueshëm objektesh apo banesash janë në procesin e legalizimit, nëpërmjet ALUIZNI-t. Bonot dhe lekët e privatizimit mund të përdoren edhe në këtë proces.

- Në privatizimin e objekteve shtetërore të dhëna me kontratë qiraje apo enfiteoze, kur këto objekte u shiten drejtpërdrejt qiramarrësve, të cilët mund të paguajnë deri në 80 për qind të vlerës me bono apo lekë privatizimi.

IV. Diskutimi në Komision.

Z. Besart Kadia, Zëvendësministër i Financave dhe Ekonomisë, paraqiti projektligjin dhe iu përgjigj pyetjeve të deputetëve.

Znj. Antoneta Dhima, relatore e projektligjit, informoi Komisionin për zhvillimet e deritanishme dhe kuadrin ligjor për bonot e privatizimit, të ndryshuar ndër vite. Ajo theksoi se nga mesi i vitit 1995, Këshilli i Ministrave filloi emetimin dhe shpërndarjen e bonove të privatizimit, si pjesë e programit të privatizimit masiv. Në këtë proces, zotëruesit e bonove të privatizimit blenë aksione të kompanive shtetërore në këmbim të bonove të privatizimit që ata zotëronin. Në procesin e privatizimit u përdorën edhe lekët e privatizimit të ish-të përndjekurve politikë.

Ligji bazë, nr.7918, datë 13.4.1995 “Për miratimin me ndryshime të dekretit nr.1030, datë 23.2.1995 “Për emetimin dhe shpërndarjen e bonove të privatizimit (lekëve të privatizimit)”, dhe dekretit nr.1049, datë 27.3.1995 “Për disa plotësime në dekretin nr.1030, datë 23.2.1995”” parashikon që, për privatizimin e pasurisë shtetërore nëpërmjet letrave me vlerë, Këshilli i Ministrave emeton "bono privatizimi". Bonot e privatizimit do të jenë të vlefshme deri në fund të vitit 1999. Bonot e privatizimit janë të formës jo emërore. Vlera e tyre përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave, në përputhje me vlerën e pasurisë së ndërmarrjeve shtetërore që do të privatizohen dhe sipas disa koeficientëve të përcaktuar në ligj.

Ky ligj përcakton se bonot e privatizimit mund të përdoren për këto qëllime:

- për të hyrë si aksionerë në shoqëritë tregtare që do të krijohen nga privatizimi i ndërmarrjeve shtetërore,
- për të blerë elemente të veçanta të pasurisë së ndërmarrjeve shtetërore që do të privatizohen,
- për të hyrë si aksionerë në shoqëritë investuese të letrave me vlerë.

Bonot e privatizimit mund gjithashtu të tregtohen midis shtetasve. Këshilli i Ministrave përcakton me vendim procedurat e emetimit dhe të shpërndarjes së bonove, rregullat e përdorimit në procesin e privatizimit, si dhe rregullat e tjera të nevojshme.

Banka e Shqipërisë shtyp bonot e privatizimit sipas karakteristikave të përcaktuara nga Ministria e Financave. Ministria e Financave përgatit dispozitat ligjore për organizimin dhe veprimtarinë e shoqërive investuese të letrave me vlerë dhe për veprimtarinë e bursës (tregut të letrave me vlerë).

Në procesin e privatizimit të pronës shtetërore, lekët e privatizimit, të përfituara nga ish-të përndjekurit politikë, si dhe obligacionet që do t'u shpërndahen ish-pronarëve për kompensimin e pasurisë së tyre, do të kenë të njëjtin trajtim si edhe bonot e privatizimit.

Ligji nr.7918, datë 13.4.1995 u ndryshua ndër vite me 7 ligje të tjera, të cilat kishin objekt shtyrjen e afatit të vlefshmërisë së bonove dhe lekëve të privatizimit, si më poshtë:

Nr.	Ligji për bonot e privatizimit i ndryshuar	Afati i përdorimit të bonove të privatizimit deri më	Zgjatja e afatit në vite
1	Ligj nr.7918, datë 13.4.1995	31.12.1999	
2	Ligj nr. 9516, datë 18.4.2006	31.12.2010	11
3	Ligj nr.10 359, datë 16.12.2010	31.12.2011	1
4	Ligj nr.10 495, datë 22.12.2011	31.12.2013	2
5	Ligj nr.136/2013, datë 29.4.2013	31.12.2014	1
6	Ligj nr.40/2015, datë 16.4.2015	31.12.2016	2
7	Ligj nr.16/2017, datë 16.02.2017	31.12.2018	2
8	Ligj nr.36/2018, datë 21.06.2018	31.12.2021	3
9	Projektligji shkurt 2022	31.12.2023	2

Siç vërehet nga tabela, afati për përdorimin e bonove dhe lekëve të privatizimit, sipas ligjit bazë të vitit 1995, ishte deri në fund të vitit 1999. Ky afat është zgjatur 7 herë me ligje specifike dhe aktualisht është deri në fund të vitit 2021. Projektligji parashikon zgjatjen e afatit me dy vjet të

tjera, deri në fund të vitit 2023. Me këtë projektligj afati i përdorimit të bonove dhe lekëve të privatizimit propozohet të ndryshohet për herë të tetë.

Relatorja e vlerësoi projektligjin të nevojshëm dhe me efekte pozitive. Në kushtet kur ekziston tregu për përdorimin e bonove dhe lekëve të privatizimit, është e nevojshme të shtyhet afati i përdorimit të tyre, për të krijuar mundësinë e përdorimit nga zotëruesit e tyre.

Gjatë diskutimit shumica e deputetëve mbështetën qendrimin e relatores, duke u shprehur dakord për miratimin e këtij projektligji.

Disa deputetë kërkuan nga propozuesit e projektligjit një informacion më të plotë lidhur me:

- Listën e objekteve që parashikohen të privatizohen gjatë viteve 2022-2023;
- Vlerën e emtuar, të shpërndarë dhe të pashpërndarë të bonove dhe lekëve të privatizimit;
- Vlerën aktuale të bonove dhe lekëve të privatizimit në treg;
- Vlerën e bonove të përdorura në procesin e privatizimit dhe atë të legalizimit të ndërtimeve informale;
- Ekzistencën e një tregu të ligjshëm dhe transparent të bonove dhe lekëve të privatizimit;
- Ekzistencën e një databaze me personat zotërues dhe grumbullues të këtyre letrave me vlerë;
- Argumentimin për zgjatjen e afatit me 2 vjet;
- Rolin e mundshëm monitorues dhe edukues të AMF në këtë treg;
- Hartimin e një strategjie për përdorimin e këtyre letrave me vlerë në treg;
- Efektet financiare të projektligjit etj.

Zëvendësministri i Financave, duke iu referuar informacionit të Bankës së Shqipërisë, theksoi se:

- Deri tani, në total, janë shpërndarë 72.7 miliardë lekë bono privatizimi;
- Nga këto, janë përdorur deri sot 37.2 miliardë lekë bono privatizimi;
- Janë ende në qarkullim 35.5 miliardë lekë bono privatizimi;
- Gjatë tre viteve të fundit (2018-2021) janë përdorur 7.2 miliardë lekë bono privatizimi.

Parashikohet që procesi i legalizimit të mbyllet brenda dy viteve të ardhshme, ndaj edhe shtyrja e afatit të përdorimit të bonove të privatizimit është parashikuar 2 vjet.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka hartuar një listë të të gjitha ndërmarrjeve dhe shoqërive të mundshme për t'u privatizuar, e cila është publikuar në faqen e këtij institucioni.

Në përfundim të diskutimit, Komisioni vendosi që, gjatë periudhës mars-prill 2022, të organizojë një seancë dëgjimore me pjesëmarrjen e Ministres së Financave dhe Ekonomisë dhe të përfaqësuesve të Bankës së Shqipërisë për t'u njohur më në thellësi me tregun e bonove dhe lekëve të privatizimit, bazuar edhe në çështjet e trajtuara në këtë mbledhje. Komisioni do të njihet me të gjitha studimet e publikuara për këtë treg, duke synuar zhvillimin dhe përfshirjen e tij në procesin e digjitalizimit dhe të teknologjisë së informacionit.

V. Përfundim.

Mbështetur në argumentet e mësipërme, Komisioni e miratoi projektligjin me shumicë votash.

RELATORJA
Antoneta DHIMA

KRYETARI
Eduard SHALSI